



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 3413/1 Prot.

Tiranë më, 30.12.2022

URDHËR

Nr. 122, datë, 30.12.2022

**“PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË ZYRËN E
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 194, pika 1, të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, dhe të nenit 214 pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 117 – 136, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për shqyrtimin e ankesave në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve, Njësia e Ndhmësinspektorëve, kabineti dhe Arkiv-Protokolli për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

